



Asambleja
01.Nr.VIII
Deçan,dt.28.09.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VIII-të, të rregullt të Kuvendit, me dt.28.09.2023.

Në mbledhje ishin prezent:25 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale (6), OSBE, OJQ.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për dy vitet e ardhshme;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit Lokal të Veprimit Rinorë,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025;
5. Shqyrtimi i draft-Planit për barazi gjinore;
6. Njoftim i Drejtorisë për Arsim për përgaditjen e vitit shkollor 2023/2024;
7. Rishqyrtim i rregullores për taksat komunale të dt.31.07.2023 me rekomandim të Ministrive;
8. Marrja e vendimit për rialokim të mjeteve buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e VIII-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 25 anëtarë të kuvendit (mungojnë: Erdogan Dauraj dhe Hamid Zukaj).

Kryesuesi ka kërkuar një minut heshtje për dëshmorin e fundit të Kosovës, rreshterin e policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili u vra në Banjskë të Leposaviqit, me dt.24 Shtator, nga grupet terroriste serbe në Kosovë, në vazhdim Kuvendi ka mbajtur një minut heshtje për Dëshmorin, Afrim Bunjaku. Në vazhdim kryesuesi e prezantoi rendin e punës të propozuar me ftesë, pastaj ka thënë se është rekomandim i KPF-së, që të shqyrtohet në të ndryshme në Kuvend- Shfuqizimi i Vendimit të Kryetarit dhe zbatimi i Rregullores komunale të dt.31.07.2019, për Caktimin e Orarit të Punës për Subjektet Afariste në Komunën e Deçanit, në vazhdim e ka hapë debatin rreth rendit të punës.

Orges Tafilaj- ka bërë vërejtje që për pikën 3 dhe 4 sot na ka ardhë materiali kurse për pikën 7 na kanë ardhë vetëm shkresat e ministrive por nuk është bashkangjitur edhe rregullorja, ndërsa kërkon që të hyn si pikë –Raportimi i Kryetarit rreth marrëveshjes me Hirodrinin.

Miftar Ahmetxhekaj-ka ngritë çështjen e miratimit të dy ligjeve nga kuvendi i Kosovës të cilat kanë të bëjnë me bjeshkët e komunës së Deçanit si Park nacional dhe dhënia me qera e t'baneve të ndërtuara në këto bjeshkë ku është caktuar afati i aplikimit deri me 12 tetor, për të gjitha këto kërkoj sqarim nga kryetari.

Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës me tri pika në të ndryshme, me rekomandim i KPF-së, që të shqyrtohet në të ndryshme në Kuvend- Shfuqizimi i Vendimit të Kryetarit dhe zbatimi i Rregullores komunale të dt.31.07.2019, për Caktimin e Orarit të Punës për Subjektet Afariste në Komunën e

Deçanit, Raporti i kryetarit rreth marrëveshjes me Hidrodrinin dhe , Debat rreth temës së marrjes me qera të parcelave në bjeshkët e Deçanit (sipas ligjit të fundit), rend dite i cili miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Në faqe nr.4 kur përmendem për here te dyte, kur është 10% për një vit ose nëse rritet prap me pasë ni indeks te vogël, është mire te ceket edhe pjesa kur kam thënë dallimi ka qene qe 5% është 180 euro dhe kjo i shtynë qytetaret qe ta paguajnë për 6 muaj sepse nuk është vlere e madhe dhe do te mbetet ajo 7.2 pra 10% meqë është një vlere e konsiderueshme dhe mund te merret parasysh nga qytetaret. Ne te njëjtën kohe te rekomandimi ku shkruan një rekomandim i fundit për komisionin e aksionarëve kam thënë se, duhet te diskutojnë se bashku me bordin e drejtorëve te kompanisë ne mënyrë qe te shikohet rritja e inkasimit nga konsumatorët komercial ku qëndrojnë dobët rreth diku 53 % ne krahasim me konsumatorët e amvisërisë ku inkasimi është mbi 90%, ne këtë mënyrë edhe do te behet krahasimi ne mes te llogarive te arketueshme dhe te pagueshme. Ne faqen 7 pyetjet, realisht kam ceke për problemin e ujit te pijes sidomos në rrugën Elena Gjika ku janë diku 10 shtëpi po ashtu kam thënë se patëm themeluar një komision qe te diskutoj me Hidrodrinin qe te rritet presioni dhe problemi me uj te pijes te zgjidhet, dhe si rekomandim ka qene qe nëse komisioni nuk është funksional atëherë te shikohet mënyra qe bashkërisht te gjejmë një rruge për te rritur presionin te kompania regjionale Hidrodrini.

Miratohet njëzëri me plotësimet te diskutimet e Orgesit.

II. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për dy vitet e ardhshme.

Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë Drejtoreshës se Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj, e cila për te pranishmit ka sqaruar se buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2024 është 13,508,082.00, prej tyre 12,660,517.00 janë nga grandi dhe shuma prej 847,565.00 janë të planifikuara nga të hyrat vetanake, vetëm për investime kapitale është shuma prej 3,124,814.00., në vazhdim drejtoresha ka sqaruar për planifikimin buxhetorë në detale.

Arjan Dobraj- në emër të grupit AAK ka thënë se projekt buxheti për vitet 2024-2026 është buxhet premtues sepse në vetvete ka përfshi investimet kapitale me shumë rëndësi për qytetarin tonë, aty janë përfshi të gjitha projektet e propozuara gjatë shqyrtimit në kuvend si dhe propozimet nga debatet publike, prandaj ne si AAK e përkrahim dhe e mbështesim këtë planifikim buxhetorë.

Hyri Dobrunaj- thotë se planifikimi buxhetor ka disa mos përputhje që nënkupton se janë disa projekte të cilat kanë qenë të planifikuara ma parë por që janë hjekë këtë vit, pastaj ka shtuar se ka dështuar projekti “Laku i Kryqës”, projekti i ndërtimit të rrugëve të bjeshkës- a ka projekt ka pyet, trajtimi i qeneve endacak është hjekë, ndërtimi i qendrës së qytetit, pastaj ka shtuar pyetjen çka nënkupton me ndërtimi i parqeve të qytetit, si projekt është hjekë ndërtimi i stacionit të autobusëve dhe pse është hjekë kërkoj arsyen, Ndërtimi i kompleksit të dëshmorëve a kini projekt të hartuar për të ka pyet ajo. Ne si LDK ka thënë ajo kërkojmë që të ndani buxhet për projektet me të cilat kini konkurrar në zgjedhje, prandaj duke parë se nuk kini planifiku projektet që kini konkuru në zgjedhje dhe kini bërë fushatë zgjedhore me to ne si LDK jemi kundër këtij buxheti dhe do të votojmë kundër.

Faton Selmanaj- thotë se edhe ky buxhet është i planifikuar dhe i koncentruar në asfalt dhe në mallra, në këtë planifikim mungojnë projektet e ujësjellësit, ruga S. Osaj sa herë duhet të ndërtohet sepse ka shumë rrugë të tjera që presin për tu ndërtuar, projekti Ndërtimi i Qendrës së qytetit-kërkon sqarim, është futë në planifikim projekti Ndërtimi i rrugës Bjeshkë e Madhe dhe ka mjaft rrugë dhe rugica në rrafsh që duhet të planifikohen para projekteve që shkojnë në bjeshkë, prandaj duke pasë parasyshë që është buxhet i keq planifikuar ne si VV do të votojmë kundër.

Mon Selmonaj- ka thënë se projekt buxheti për vitin 2024 nuk është planifikuar mirë, nuk ka shifra krahasuese me vitin 2023, nuk i ka të detalizuara shpenzimet për secilin kod buxhetor, nuk ka të dhëna në sintetikë dhe analitikë për secilin program buxhetor. Projekt buxheti i ofruar është krejtësisht shpenzues dhe jo buxhet i paraparë për zhvillimin e komunës, sepse 54% të mjeteve shkojnë për paga dhe mëditje, 18.86% mallra dhe shërbime që kryesisht janë shpenzime të luksit, të zyrtarëve komunal, 1.8 % për shërbime komunale, 2.14% për subvencione, kurse për investime

kapitale ku më së shumti përfiton qytetari janë ndarë vetëm 23%, dhe nëse i shikojmë edhe shifrat për dy vitet pasuese pothuajse janë të njëjta dhe pa alternativë zhvillimore. Është për keq ardhje që mjetet që po planifikohen nuk po shpenzohen për atë destinacion dhe kjo e tregon zyra e auditorit të përgjithshëm përmes raporteve të auditimit për pasqyrat finnaciare që për shumë vite ka qenë opinion i kualifikuar, 791 euro është paga mesatare mujore e të punësuarve në zyre të kryetarit, 2131€ janë planifiku për kokë punëtori mallra dhe shërbime, ndërsa në administratë 556 euro është paga mesatare dhe 300 euro për mallra dhe shërbime për çdo të punësuar prandaj kërkojmë sqarim nga kryetari se ku shkojnë të gjitha këto mjete në zyrë të tij për mallra dhe shërbime.

Te investimet kapitale vërehet një orientim i gabuar, projekte të cilat me vite po investohet në to dhe nuk kanë përfundim, , siq janë: Fshati Turistik Podi i gështenjave, Laku i Kryqës, Shtëpia Alpine Bjeshkatore, Bjeshka e Madhe me tri projekte njëherazi, Belleja etj., disa projekte janë nga 2-3 herë në planifikim për vitin 2024, që nuk dihet nga kush menaxhohen. Tendenca e Ekzekutivit për ti arsyetuar këto investime me zhvillimin e turizmit duke anashkaluar të gjithë sektorët tjerë që qojnë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shpejtë ekonomik.

Propozoj që në këtë projekt buxhet të përfshihen, në Investimet në Infrastrukturë, Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore për ta rritur sigurinë në trafik siq janë: mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe shenjëzimi vertikal dhe horizontal. Prioritet mbi prioritete duhet të ketë ndërtimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza për të mbrojtur burimet ujore dhe mjedisin. Ndërhymja me urgjencë në sanimin e shtretërve të lumenjve, posaçërisht të lumit të LLloqanit i cili vitin e kaluar ka shkaktuar dëme të mëdha në fshatrat Rastavicë dhe Baballoq.

Përmirësimi i shërbimeve publike-Investimet në shëndetësi, përmirësimi në infrastrukturën shkollore duke përfshi ambientet e brendshme , të jashtme dhe paisja me mjete mësimore moderne.

Zhvillimi ekonomik me fokus bizneset- te ky sektor ish dashtë të parashihet mbështetje financiare dhe hartimi i projekteve të ndryshme që e promovojnë turizmin malorë dhe kulturën vendore.

Mbështetja sociale dhe kulturore, këtu duhet të bëhet financim i programeve sociale për të ndihmuar familjet me nevojë dhe grupet e rrezikuara të interesit.

Përmirësim i infrastrukturës urbane- riparim i trotuareve të dëmtuara dhe vendkalimeve për persona me aftësi të kufizuar, mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit dhe kanaleve për ujërat sipërfaqësorë..

Prioritetet në bujqësi- rritja e buxhetit nga 200 000 euro në 500 0000 euro, si njëra nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik. Dhe krejt në fund kërkon që të hapet diskutim për propozimet e tij në mënyrë që këto propozime të hyjnë në planifikimin buxhetor.(diskutim i dorëzuar në kopje fizike që ruhet në dosje me materialin e mbledhjes)

Kryetari- përgjigjet në çështjet e ngritura, ai ka thënë se janë disa parime mbi të cilat bëhet planifikimi i buxhetit, sa i përket fshatit turistik Laku i Kryqës, ai ka thënë se ne e kemi marrë një vendim ketu në kuvend ku është bere shpallja e pronës me interes publik ku hyjnë 750 hektar në disa lokacione në bjeshkët tona, njëra nga këto parcela është edhe Hapësira për Kamping “ Laku i Kryqës” më sipërfaqe S=150000 (15 ha), e kemi një shteg Via Ferrata, e kemi një vendim të kuvendit për elektrifikim te bjeshkëve të komunës se Deçanit, dhe për të gjitha këto projekte që planifikojmë të bëjmë zhvillimin e turizmit në Komunën e Deçanit, unë si kryetar e kam një drejtor të drejtorisë të cilit ju ka ngritë aktakuza, mirëpo për këto projekte kërkojmë mbështetjen e qeverisë sepse me mjetet tona është e pamundur ti realizojmë , projekti rruga Qendra e qytetit në këtë projekt kemi investua prej pompës Agonisi ne Carrabreg deri te fshati Lëbushë, e kemi hartu një projekt vetëm për qendrën e qytetit por ende jemi ne procedura te diskutimit dhe debatit me qytetar për të arritur deri te verzioni final, e kemi projektin.

Memoriali i Dëshmorëve ku do të përfshihen krejt dëshmorët e komunës së Deçanit dhe do të ju bëhet nderim të gjithëve njejtë ditën e dëshmorëve të komunës me dt. 5 dhe 6 Maj, mirëpo i përkrahi projektet tjera siq janë Ujësjellësi në Bjeshkë të Madhe dhe bjeshkë tjera, Lumi Baballoq-shtrati i lumit, per kete kam premtim se në vitin 2024 do të jetë një kod buxhetor në Ministrinë e Ambientit dhe do të realizohet si projekt, Qentë endacak- sa i përket kësaj çështje i kemi marrë dy mësim nga dy komuna që kanë investu në këtë drejtim por nuk kanë qenë të suksesshme metodat e përdorura. Për Fatonin, rruga e Gushavcit- sa i përket kësaj rruge i kemi ba tri takime me qytetar –pronar të

tokave rreth asaj rruge, ata e kishin ni komision, që më ka thënë se mos puno pa na i pagu megjat që na i merr, në Qershor kemi fillu mi punu kete rruge me zhavorr dhe komuna nuk mund ta merr përsipër kompensimin e te gjitha atyre megjave sepse është kosto e madhe dhe nuk kemi buxhet. Podi i gështenjave- ju ftoj mi vizitu dhe me pa çka kemi punu aty, kolonia e artisteve, bazeni olimpik, 14 villa që lirisht mund te them se po del një nga projektet ma te mira një kompleks qe ka me na hy ne punë shum si aset i vlefshëm komunal dhe shtetërorë, e kemi fazën përfundimtare- që pritët të lëshohet në funksion në tetor këtë vit ndërsa punimet përfundojnë krejt vitin e ardhshëm. Rruga Qendra- ne Deçan duhet me qenë një baj pas, në mënyrë që të shkarkohet komunikacioni nga qendra, që ne si komunë nuk kemi mundësi financiare që ta bëjmë vet, stacioni i autobusëve, Stacioni i autobusëve është në kontest gjyqësorë dhe deri sa ka kontest ne nuk mund të veprojmë si komunë aty, rezervuari 10 fshatrave- janë në procedurë të tenderimit, për Monin, kanalizimi nuk ka buxhet për të sepse është projekt që kushton, Lumbardhi i Lloqanit e sqarova, Komisioni për vërsime e ka ba punën e vet por shqetësimi ma i madh është Ura e Vranocit dhe kjo temë nuk është përmbyllë, te ujëmbledhësi- është projekti parë që është hartu por që ka të bëjë me liqejt akumulues në grykën Hulaj- vlera 28 mil. I cili është dërgu në të gjitha ministritë për përkrahje financiare, u përmend nga Moni investimi në sektor të caktuar siq është bujqësia por unë nuk mendoj ashtu, dhe këtë vit turizmi ka qenë në qendër të vëmendjes. Me plot gojë e them se Komuna e Deçanit e ka një të ardhme-Qasjen drejt pasurisë që ja ka lanë Zoti(bjeshkët). Për Orgesin, Me Hidrodrinin e kemi nënshkru marrëveshjen për kanale të ujitjes, te ligji mbi pyjet mbi parkun (për Miftarin) ne kemi pasë të drejt dhe kemi punu në atë drejtim që duhet të ndryshohet ligji, sepse ligji i miratuar mbi pyjet ka me i ba dam këtij vendi.

Miftar Ahmetxhekaj- pyet, a mundesh mi marrë një iniciativë që mi shty afatin e aplikimit për bjeshkë nga 12 tetori sa është, për më tutje.

Florim Mataj- thot se shqetësim imi dhe i bashkëfshatarëve të mi nga fshati Baballoq është rregullimi shtratit të lumit Lloqanit në Baballoq, i cili nuk është parapa në buxhetin 2024-2026, kish qenë mirë që edhe ne mi pasë një kod-jo veq nga ministria me pritë me na ndihmu.

Yllarta Thaqi- thotë se u përmendën shumë projekte, sa i përket bujqësisë unë kërkoj ma shumë, Kulla te Verrat e Llukës- 30.000 euro jan shum pak për këtë projekt.

Kryetari- nuk thash që nuk do të kemi vëmendje te bujqësia por është diqka tjetër me kërku vëmendje, Kulla te Verrat e llukës- ekziston ni parim kur ti e ndanë një pjesë të mjeteve për mi lidhë ni kontratë besoj janë të mjaftueshme e pastaj me shiqu mundësitë e thithjes së mjeteve buxhetore nga ministria.

Orges Tafilaj- rritja e buxhetit konsiston me rritjen e qeveritare të buxhetit, ki thanë se nuk ka mbështetje nga qeveria por kjo nuk qëndron sepse ki pasë mbështetje nga qeveria në disa projekte të caktuara, te deponitë pse mbetet projekti në 2025.

Kryetari sqaron se Qendra rinore (për Orgesin) ka fillu realizimi i projektit në mandatin e kaluar dhe investimi ka qenë i përbashkët gjysë-gjysë komuna dhe ministria kurse fshati turistik është krejt i joni, ministritë na kanë përkrahë Qeveria jo.

Blinera Lokaj- thotë se projekt buxheti është qështja ma e rëndësishme, sipas këtij propozimi shumica e buxhetit shkon për turizëm, kurse ne banorët e regjionit të Vokshit ballafaqohemi me mungesën e ujit të pijes, mungesë të ndriçimit publik, dhe pyetja ime është pse është hjekë projekti ujësjellësit nga planifikimi buxhetor.

Sylë Balaj- thotë se në planifikimin buxhetor nuk është asnjë projekt për fshatin Isniq, së paku një Qerdhe sikur ta kishim, nuk ka as trotuare dhe as projekte të ujësjellësit për Isniq.

Kryetari- e kemi një kontratë me Hidrodrinin për krejt fshatrat.

Miftar Ahmetxhekaj-u thanë pjesa dërmuese e atyre që kam planifikuar ti them, por sa i përket projekt-buxhetit do te duhet ti përmbante dy elemente apo parime, planifikimi i saktë i buxhetit dhe shpërndarja e buxhetit duke u mbështetur në prioritete për nga rëndësia gjë që nuk është bërë nga Kryetari dhe drejtoresha e buxhetit, shpërndarja nuk është mbështetë në nevojat e qytetarëve. Struktura e buxhetit të Komunës së Deçanit për vitin 2024 i cili në total është 13 508 082 është kjo: Paga dhe mëditje 7 294 440 ose 54% e buxhetit dhe kjo është sepse vetëm në zyrën e kryetarit janë të

punësuar 18 zyrtarë, Mallra dhe Shërbime 18%, Subvencione 2.1%, Komunal 1.8%, Investime kapitale 23%. Shqetësuese është forma e planifikimit dhe shpërndarjes së investimeve kapitale e këtë e tregon tabela e projekteve kapitale për vitin 2024. Pjesa dërmuese e projekteve janë projekte në vazhdim të viteve të kaluara sepse edhe atëherë ka pasur keq planifikim të buxhetit aspak të mbështetura në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Në këtë projekt buxhet nuk pashë asnjë planifikim për lokalitetin prej nga vi unë, fshati Isniq, si tatim paguesi ma i madh i komunës edhe pse ka nevoja imediate siç janë: kanalizimi, kanale të ujitjes, çerdhe për fëmijë, mungesa e hapësirave kreative, mungesë e trotuareve, ndriçim gjysmak etj.. Edhe aty ku është bërë planifikim i projekteve të reja nuk janë bërë në ato projekte me prioritet por pjesa dërmuese e investimeve kapitale janë të destinuara për bjeshkë. Nuk është interes i qytetarëve investimi në pjesën e bjeshkëve dhe unë kam me lypë sqarim për projektin Shpia Alpine. Përfundimisht ky nuk është buxhet premtues, për veç i shpenzuar keq dhe ne raste të caktuara duke i tejkaluar autorizimet ligjore (Diskutimi është dorëzuar edhe në kopje fizike dhe do të ruhet në dosje me materialin e mbledhjes).

Kryetari- thotë se është gabim të thuhet se nuk është bërë asgjë, u nale të projekti i shpisë alpine, ndërsa me duhet të sqaroj se ne për këtë projekt e kemi vendimin e kuvendit i cili është shpallë i ligjshëm, kryetari ka sqaruar edhe për temat tjera të cekura ndërsa ne fund të fjalës se tij ka kërkuar nga asamblistët që ta përkrahin këtë buxhet.

Vatan Istrefaj- thotë se projekti në nr. Rendor 2 ka qene i njëjti edhe vitin e kaluar, dhe tash shtroj pyetjen se cilat fshatra fillojnë të investohet tash me këtë buxhet., nga planifikimi buxhetor është largu projekti Elektrifikimi i bjeshkës së Strelcit dhe unë kërkoj sqarim me qëllim arsye është bërë kjo, dhe këto ishin vërejtjet e mia për të cilat do të votoj kundër ka thënë ai.

Kryetari- sqaron se në vitin 2019 kemi fillu me elektrifikimin e bjeshkëve, dhe për këto projekte kemi pasë premtime se do të na përkrahin por kjo nuk ka ndodhur, ndërsa sa i përket elektrifikimit të Bjeshkës së Strelcit, ju vet e keni marrë përsipër hartimin e projektit por nuk e keni bërë, ndërsa sa i përket ndërtimit të rrugëve Lloti nr.3 i përmbanë të gjitha rrugët e komunës së Deçanit që kanë mbetur të pa asfaltuara ende.

Leortim Hadergjonaj- ka thënë se komuna e Deçanit me këtë buxhet sa kemi pasë për investime kapitale ka ndërtuar mjaft dhe këto janë gjëra që shihen mirë, edhe në këtë projekt buxhet ka planifikuar projekte që janë në interes të drejtë përdrejt të qytetarit, 15 km. Kanal betoni i ujitjes janë të planifikuara në buxhet, trotuare në fshatra mbi 10 km, rrugët e fshatrave janë në buxhet, zhvillimi ekonomik përmes turizmit, rrugët e bjeshkës- mirëmbajtje mbi 60 km. Ndërtim i 6 urave në rrugët e bjeshkëve, faza e parë deri te Laku i Kryqës, shenjëzimi i rrugëve të bjeshkëve, përfundimi i fshatit Alpin dhe kjo është arsyeja pse ne sot duhet ta miratojmë këtë buxhet ka thënë ai.

Teuta Neziraj- ka thënë që disa fjalime të kolegëve këtu janë absurde dhe nuk pajtohem me ta, pas kësaj ka asfaltime të rrugëve të cilat nuk është rregulluar infrastruktura nëntokësore dhe ai asfalt prap duhet mu prishë, investimi në bjeshkë si investim në turizëm- a duhet na tash mi braktisë rrafshin e me shku me jetu në bjeshkë.

Hyri Dobrunaj-thotë Kryetari me pasion po flet për bjeshkën, mirë po duhet të kenë përparësi investimet në rrafsh, nuk ka buxhet të planifikuar as në aspektin gjinorë, Qerdhe nuk ka dhe shumë projekte tjera që duhet të kishin përparësi planifikimi.

Kryetari- dy Qerdhe sivej fillojnë të ndërtohen.

Kryesuesi- meqenëse u debatua mjaft dhe u shterr diskutimi rreth buxhetit për vitin 2024 dhe dy vitet pasuese e qiti në votim, anëtarët e kuvendit e miratojnë me shumicë votash buxhetin për vitet 2024-2026, rezultati i votimit ishte, 14 për (pozita) 11 kundër(opozita).

II. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimtari Rinorë.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fillimisht fjalën ia ka dhënë drejtoreshës së drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, Leonora Ukëhajdaraj, si propozuese e këtij plani.

Drejtoresha ka sqaruar se si ka shkuar procedura e shqyrtimit të këtij dokumenti, ajo ka thënë se diskutimi publik ka dështuar për shkak të mos interesimit për pjesëmarrje, mirëpo në konsultim me OJQ-të lokale, OSBE si dhe me nxënësit është mbajtur kuvendi i KVRL-së, dhe janë zgjedhur strukturat udhëheqëse dhe është funksionalizuar KVRL, ka thënë ajo.

Arjan Dobraj- thotë se ka qenë propozim që me pasë aktivitete për inkuadrim të rinjëve të viseve rurale dhe kjo është marrë parasyshë, me mjete buxhetore janë mbështetë dhe kjo është pjesë e planit, dhe vetëm ju uroj suksese dhe punë të mbarë sepse kjo është mjaft inkurajuese.

Hyri Dobrunaj- thotë, e uroj zgjedhjen e KVRL-së, por kisha dashtë që për këtë plan me fole Grupi i të rinjve të asamblesë sepse ata janë të thirrur me fole për këto tema.

Faton Selmanaj-thotë se dua ta komentoj përzgjedhjen e strukturave të KVRL-së, që nuk ka legjitimitet zgjedhja e kryesuesit të KVRL sepse aty kanë marrë pjesë vetëm 6 antar.

Mon Selmonaj- edhe mbledhjen e kaluar e kam ngritë çështjen e 75 euro për dy përgjegjës aktiv me orar të shkurtuar kater ore ne dite me pag mujore 75€ dhe kërkoj të di se a është përfshi në plan rritja e kësaj shume.

Drejtoresha, Leonora- sqaron se është rregull që në kuvendin e KVRL-së me marrë pjesë përveç të rinjëve edhe OJQ-të dhe OSBE, dhe ne i kemi përmbushë këto kriteret, KVRL financohet nga buxheti komunal ashtu si e keni propozu dhe nga donatorët

Orges Tafilaj- ka thënë se si pikë në rend dite është shkruar herën e parë plan e tash draft dhe kjo nuk është në rregull, dhe çështja tjetër ka të bëjë me pagesën ku parashihen dy përgjegjës aktiv me orar të shkurtuar me pagë mujore 75 euro, i cili ka qenë propozim që të ndryshohet por nuk janë bërë këto ndryshime dhe kjo shumë duhet të rritet së paku 125 euro në neto.

Vatan Istrefaj- kërkon që të hiqet fjala draft, pastaj thot se më vjen mirë që e keni mbajte kuvendin dhe i keni zgjedhë strukturat dhe kryesuesin e KVRL, por kemi pritë që do të na ftoni neve grupin e asamblistëve të rinjë për të marrë pjesë në kuvend, për të cilin i kam vërejtjet i mia për mos ftesë. dhe anashkalim.

Kryesusi e qiti në votim, antarët e Kuvendit e miratojnë me ndryshimet e propozuara Planin e Veprimt Rinorë 2023-2026, rezultati i votimit ishte 24 për 1 abstënim.

IV. Shqyrtimi dhe miratimi i draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025.

Kjo pikë hiqet nga rendi i ditës, meqenëse nuk ka ardhë askush nga ZLKK për ta mbrojtë si temë, si propozues të kësaj pike që kanë qenë.

V. Shqyrtimi i draft-Planit për barazi gjinore.

Kryesuesi e ka prezentu pikën pastaj për sqarime ka ftuar Ajne Iberhysaj si hartuese të këtij plani, e cila ka sqaruar se miratimi i këtij plani është kërkesë e domosdoshme, ajo në vazhdim ka kërkuar mbështetje nga grupi punues për hartimin e këtij dokumenti i themeluar këtu në kuvend, mbështetje të grupit në mbajtjen e debatit publik dhe dy punëtori së paku para miratimit të dokumentit final, ajo ka thënë se dokumenti i hartuar është në harmoni me dokumentet e nivelit qëndrorë, Kushtetutën e Kosovës, të gjitha Ligjet dhe programet zhvillimore (fq.7).

Yllarta Thaqi- thotë e përgëzoj Ajnën për punën e mirë që ka bërë, shpresoj të realizohet pikë për pikë sepse ja vlenë, parimisht e përkrahi dhe jam për.

Hyri Dobrunaj- faleminderit Ajne për hartimin e këtij drafti shumë të mirë, por më vjen keq që nuk ka mu zbatu asnjëherë, në vazhdim i ka cekë tri shtyllat që nuk ka me ndodhë dhe kjo bëhet vetëm mi përmbushë një obligim ligjorë të disponimit të këtij plani Komuna e Deçanit, në fq. 6 duhet të shkruhet gra dhe burra jo femra dhe meshkuj, ndërsa unë e votoj sepse ki punu shumë ti Ajne.

Teuta Neziraj-e përgëzoj Ajnën për hartimin e këtij dokumenti, kurse sa i përket zbatimit jam skeptike.

Mon Selmonaj- e vlerëson si një material shumë të mirë.

Orges Tafilaj-urime Ajne për punën e mirë që ke bërë, vërejtje për të gjitha këto plane që po vijnë në kuvend- te referenca te ju referoheni për të njëjtën çështje shënimeve të njejt, si psh te numri i banorëve, te rregullohen gabimet drejtshkimore, nr.banorve fq.13 përqindja gra dhe burra, në fund lista e aktiviteteve të cilat kanë implikime buxhetore të gjitha, dhe jam skeptik.

Florim Mataj-falënderon Ajnën për punën e mirë që ka bërë, shpresoj se do të realizohet ky plan edhe te bursat e studentëve është realizu kuota gjinore.

Hyri Dobrunaj- kam qenë e knaqur që bursat janë nda ma shumë për femra, por ka qenë rastësi, por nga ana tjetër një tregus i mirë që vajzat shkollohen ma shumë.

Florim Mataj- isha i qartë se është thy ajo tabu, nuk ka asgja të keqe, gjinisë femërorë po i ipet hapësirë, dhe nuk pata asgja personale me kerkend.

Faton Selmanaj- thotë se i kemi edhe disa pika të rendit të ditës dhe askush nga ekzekutivi nuk është prezent në mbledhje të cilët edhe nuk e shofin punën e jashtëzakonshme që ka bërë Ajna, e kjo është për çdo kritikë.

Miratohet njëzëri (21 prezent) draft-Planit për barazi gjinore në leximin e parë i njëjti nënshtrohet procedurës së konsultimit publik.

Ajne Iberhysaj- i ka falënderu asamblistët për vlerësimin e mirë që i kanë bërë punës së saj.

VI. Njoftim i Drejtorisë për Arsim për përgaditjen e vitit shkollor 2023/2024.

Kryesuesi- e ka prezentu piken, pastaj ka shtuar se drejtori i arsimit nuk qenka prezent por ju e kini me shkrim njoftimin që e ka sjellë drejtori.

Orges Tafilaj- thotë se jemi marrë vesh që për çdo çështje që nuk është spozorizuesi mos ta shqyrtojmë por edhe ashtu ky është vetëm njoftim.

VII.Rishqyrtim i rregullores për taksat komunale të dt.31.07.2023 me rekomandim të Ministrive.

Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj ka shtuar se janë shkresat e disa ministrive të cilat na kanë rekomanduar për harmonizim të rregullores , shkresat e ministrive i kini në dispozicion.

Florim Mataj- thotë të gjitha ato rekomandime duhet drejtorët e drejtorive me i harmonizu me tekst, çdo njëri drejtor në drejtorinë e vet.

Miftar Ahmetxhekaj- thotë ne i kemi rekomandimet e ministrive por nuk e kemi edhe rregulloren si dokument bazë, sepse nuk e di çka po votohet në këtë rast, për këtë arsye propozon që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër ku do të paisemi edhe me dokumentin bazë – rregulloren për taksa komunale.

Orges Tafilaj- thotë kështu si ka ardhë pa dokumentin bazë ne nuk dijmë çka po ndryshohet dhe plotësohet si dhe çka po votohet..

Florim Mataj- ne jemi kah folim për rekomandimet e ministrive, këto duhet të dalin në votim, e këto i kini në dispozicion.

Yllarta Thaqi- thotë se ne si komision kemi punuar mjaft për harmonizim të tekstit të rregullores, edhe pse janë kthyer po du me besë se ekzekutivi do ti bënë ndryshimet në drejtoritë përkatëse që është rekomanduar.

Vatan Istrefaj- ne po i shofim rekomandimet por po mungon dokumenti bazë.

Kryesuesi- e qiti në votim rekomandimet e ministrive për harmonizim të tekstit të rregullores mbi taksat komunale të miratuar me dt.28 shtator, antarët e kuvendit e miratojnë me shumicë votash, rezultati i votimit ishte 11 për, 10 kundër 1 abstenim.

VIII. Marrja e vendimit për rialokim të mjeteve buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë, pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtoreshës së drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, e cila sqaron se po kërkohet rialokim të mjeteve financiare për arsye se tash nuk po kemi kohë të mjaftueshme për shvillim të procedurave të tenderimit dhe nuk e kemi të gatshëm projektin për këtë fshat.

Arjan Dobraj- pasi që nuk po mund të zhvillohen procedurat e përkrahim propozimin për rialokim të mjeteve.

Hyri Dobrunaj- kur thash ma herët se nuk kini projekt të Laku i Kryqës nuk u pajtuat kurse tash po kërkoni rialokim të mjeteve në mungesë të projektit , mirëpo meqenëse kërkohet që këto mjete të rialokohen atëherë unë propozoj që të rialokohen në projektin” Ndërtimi i rezervuarve të ujit të pijes” të hapet një kod i ri për të.

Drejtoresha- për me hapë kod të ri nuk kemi kohë të mjaftueshme.

Faton Selmanaj- thotë, grupi jonë e përkrahë kërkesën.

Mon Selmonaj- pyetje,si është e mundur të ndahet shuma prej 100.000 euro për një projekt inekzistent, a mos është pengesë leja ndërtimore e këtij projekti nga institucionet tjera. A do ishte ma mirë që kjo shumë e mjeteve të orientohen në ndonjë projekt tjetër më madhorë se sa në projektin e ofruar për ndriçimin eficient të këtyre fshatrave e që ka vlerën 1.204.60 euro. Çfarë do bëni me mjetet e miratuara pak më parë me projekt buxhet për këtë projekt të ndriçimit eficient të

këtyre fshatrave për vitin 2024, e që ka vlerën 200 mij euro. Propozoj që këto mjete të destinohen për rregullimin e shtratit të lumit Lloqan.

Drejtoresha Dafina ka dhënë sqarime në çështjet e ngritura, mes tjerash ajo ka thënë se ne e kemi vlerësuar si ma të rëndësishme rialokimin e mjeteve në këtë projekt sepse për procedura tjera nuk kemi kohë.

Florim Mataj- na ma herët patëm kritika se krejt buxhetin e kini qu ne bjeshkë, kurse tash ky projekt është për ndriçimin e fshatrave dhe duhet përkrahë.

Orges Tafilaj-thotë na e dhamë mendimin tonë për këtë projekt, pastaj ka kërkuar sqarim rreth kontratës me kompaninë.

Drejtoresha Dafina- ka sqaruar se është kontratë projekt në vazhdim.

Kryesuesi e qiti në votim, anëtarët e asamblesë e miratojnë me shumicë votash, 16 për (AAK, VV dhe PDK) 7 abstenim (LDK).

IX.Të ndryshme.

1 Shfuqizimi i vendimit të Kryetarit dhe zbatimi i rregullores komunale për orarin e subjekteve afarsite.

Florim Mataj- thotë se për këtë çështje ne si asamble mund ti drejtohem kryetarit me një kërkesë për shfuqizimin e vendimit të vet dhe zbatimin e rregullores.

Vatan Istrefaj-ka paraqitë kërkesën e subjekteve afariste me të cilën kërkohet zbatim i rregullores për orarin e bizneseve., pastaj propozon shfuqizimin e vendimit të kryetarit dhe zbatimin e rregullores komunale.

Faton Selmanaj-ka ngritë çështjen e orarit të barnatoreve, të cilin e kanë me rrotacion me punu ditën e vikendit dhe festave zyrtare, duke kërkuar që një barnatore me qenë e hapur afër QKMF-së gjithmonë edhe ditëve të vikendit dhe festave, dhe kjo për hire të shërbimit më të lehtë dhe më të afërt për qytetarët.

Drejtoresha e drejtorisë për Shëndetësi, Agnesa Vokshi- ka sqaruar duke thënë se unë e kam pasë një takim me shefat e barnatoreve dhe kam kërkuar nga ata që një barnatore afër QKMF-së me punu ditën e diel.

Faton Selmanaj-thotë se te neni 10 pika 4 e rregullores mund të bëhet ndryshim.

Florim Mataj- thotë se ne sot e kemi ba një kërkesë mi shfuqizu vendimin e kryetarit dhe nuk është temë ndryshimi i rregullores.

Orges Tafilaj- sot jemi këtu mi shfuqizu vendimin e kryetarit, nëse rregullorja sna pëlqen atëher i hyjmë procedurës së ndryshim plotësimi.

Miftar Ahmetxhekaj- proceduralisht a kemi të drejtë ta bijmë këtë vendim.

Hyri Dobrunaj- sa ju përket procedurave u sqaru.

Kryesuesi- ne i rekomandojmë kryetarit mi shfuqizu vendimin e vet për pezullim të zbatimit të rregullores. Njëzëri miratohet ky rekomandim. (23 prezent).

2.Njoftimi i drejtorit të arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/24.

Drejtori i Arsimit, Besnik Hulaj, ka sqaruar për përgaditjet që janë bërë për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/24, mes tjerash ai ka thënë se të gjitha shkollat kanë ndriçim eficient, furnizimi me dru për nzemje është kontrakti për ato shkolla që nxehen me dru, edhe për furnizim me pelet është bërë për ato shkolla që përdorin peletin për ngrohje, është kontraktuar edhe nafta për ngrohje për dy shkollat e mesme, poashtu ka njoftuar se do të caktohet ni lokacion në oborrin e shkollës në fshatin Isniq për ndërtimin e një Qerdhe për fëmij. Problem kryesor mbetet furnizimi me tekste shkollore në të gjitha shkollat.

Faton Selmanaj- kur jemi te ngrohja e shkollave, në fshatin Rastavicë janë kontrakti 100m kub dru kurse në dukje janë diku 50-60 m.

Drejtori, Besniku- për çdo shkollë është menaxheri i kontratave, ato pranohen nga drejtori i shkollës, por nuk kamë pasë ndonjë ankesë të kësaj natyre deri tash nga askush, jemi në procedurë të furnizimit me pelet i cili është porositë dhe tash na ka mbete me ardhe vetëm nafta.

Faton Selmanaj-dyshoj se aty (ne shkollën Rastavicë) nuk janë 100 m dru dhe ju bëj thirrje që ta hetoni këtë rast sepse kam dyshime se nuk janë 100 m.

Drejtori, Besnik Hulaj- unë nuk e kam asnjë ankesë se ka mangësi.

Albesa Cacaj-Investimi te objekti shkollor “Lidhja e Prizrenit”, deri kurë ka me vazhdu sepse kurrë nuk po mbaron, pastaj njofton se si komitet i komiteteve kemi dalë në teren në shkollat në Rastavicë dhe Prapaqan ku kanë qenë prezent drejtorët, për me ditë sa janë pajisë komunitetet pakicë me libra shkollor.

Drejtori- sqaron se për shkaqe te tenderit ministria na ka njoftu se janë ndërpre punimet në shkollën Lidhja e Prizrenit”, sa i përket komuniteteve pakicë fëmijët e tyre janë të pajisur krejt me tekste shkollore.

Yllarta Thaqi- në KPF e kemi ngritë edhe jemi dakordu që të gjitha shkollat me pasë një uniformë për nxënës, nisni diskutimet me të gjithë akterët që lidhen me këtë çështje në mënyrë që të gjitha shkollat ta kenë ni uniformë, të respektohet kodi i veshjes në të gjitha shkollat.

Drejtori thotë, hera e dytë ose e tretë që po bisedojmë për uniforma, gjimnazi e kanë uniformën që duhet të veshët në shkollë, por jasht objekteve të shkolles ne nuk kemi mundësi ti kontrollojmë dhe asesi ti detyrojmë ta veshin nxënësit uniformën. Vetëm brenda objektit shkollor ne mund të veprojmë., si iniciativë e marrim parasyshtë dhe bisedojmë me këshillin e prindëve, por nuk është obligative.

Hyri Dobrunaj- nuk pajtohna me thënien se nuk mund ta përcaktojmë kodin e veshjes, ne e kemi ni rregullore që duhet mi respektu.

Drejtori- ne e kemi ni rregullore mbi kodin e veshjes të 2018-ës ose 202019, që e rregulloen çështjen vetëm brenda rrethojave të shkollave dhe kemi të drejtë vetëm brenda rrethojave të shkollës, jashtë nuk kemi mundësi.

Florim Mataj- me të drejtë është ngritë kjo çështje, ju si drejtor bashkë me prind angazhonu që secila shkollë ti bartë uniformat, për ata prind që nuk kanë mundë financiare mi ble ju ndihmojmë, kjo punë mund të rregullohet, është mirë me fillu me procedurë sa ma parë.

Kryesuesi e mbylli debatin rreth kësaj teme.

Të ndryshme.

Orges Tafilaj - Cekë mungesën e drejtorve që po përsëritet në secilën seancë të kuvendit, dhe Ngritë çështjen e potencuar ma parë të thymjes së xhamava në shkollën time thotë ai.

Drejtori thot se komuna e ka ni kontratë për këto punë për shkolla, at kontratë e kryen drejtoria e Shërbimeve publike.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ